



- I. Mbyllet rasti me Nr. prot. AUYXVD-0047, për zyrtarin e lartë publik z. Ilmi Azemi, Drejtor i Prokurimit, Komuna e Vushtrisë, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, në ushtrimin e funksionit publik.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë publik z. Ilmi Azemi, Drejtor i Prokurimit në Komunën e Vushtrrisë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/1-011, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: LPKI).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka filluar trajtimin e këtij rasti pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit pasi që, siç theksohet në kërkesë (citojmë): “[...] Ilimi Azemi Drejtor i Prokurimit në Komunën e Vushtrrisë, duke pasur pozicion publik, angazhohet në dy autoritete kontraktues në Komunën Vushtrrisë dhe në Komunën e Mitrovicës, duke ndërmarr veprime ligjore që ndërlidhen me nënshkrimin e kontratave publike. Të hetohet nëse Ilimi Azemi në rast të angazhimit nga dy institucionet publike, ka hequr dorë nga njëra pagës sipas nenin 13 paragrafi 2 i LPKI-së[...].”

Agjenci për Parandalimin e Korrupsionit konform mandatit dhe kompetencave ligjore që i ka sipas Ligjit Nr.08/-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar hetim administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar pretendimet për konflikt të interesit, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit Agjencia përmes shkresës zyrtare DPKI-06-481/25, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Ilmi Azemi, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Më qëllim të sqarimit të plotë të pretendimeve të ngritura nga raportuesi i rastit për zyrtarin e lartë publik z. Ilmi Azemi, Drejtor i Prokurimit në Komunën e Vushtrrisë, është organizuar dhe mbajtur një takim me zyrtarin në fjalë, me ç' rast i njëjti është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit, të ngritura për konflikt të interesit.

Në takim, zyrtari i lartë publik ka paraqitur argumentet dhe qëndrimet e tij lidhur me rastin në fjalë duke theksuar: *“Bazuar në nenin 23 paragrafi 3 të Ligjit për Prokurimi Publik, Komuna e Vushtrrisë dhe Komuna e Mitrovicës së Jugut, kanë lidhur marrëveshje të bashkëpunimit, për ofrimin e përkohshëm të shërbimeve të prokurimit publik. Ku me vendim të Kryetarit të Komunës jam caktuar si zyrtarë përgjegjës për ofrimin e përkohshme të shërbimeve të prokurimit publik për Komunën e Mitrovicës së Jugut. Shërbime të cilat i kam kryer pa kompensim dhe deri sa ka përfunduar procedura e rekrutimit të pozitës së zyrtarit përgjegjës të prokurimit në Komunën e Mitrovicës së Jugut”*.

Nga informatat që përmban kërkesa e raportuesit të rastit, diskutimi nga takimi i mbajtur si dhe informacioni/ dokumentacioni i siguruar, rezulton gjendja faktike si në vijim:

Me datë 16.12.2024, Marrëveshja e bashkëpunimit, e nënshkruara nga Kryetar i Komunës së Vushtrrisë dhe Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, për ofrimin e përkohshëm të shërbimeve të prokurimit publik;

Me datë 16.12.2024, Vendimi i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë, me të cilin z. Ilmi Azemi, Drejtor i Drejtorisë për Prokurimi Publik, caktohet zyrtar përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit 02Nr.1803/24 datë 16.12.2024, në mes Komunës së Vushtrrisë dhe Komunës së Mitrovicës së Jugut, për ofrimin e përkohshëm të shërbimeve të prokurimit publik.

Bazuar në gjendjen faktike si më lartë, diskutimi nga takimi i mbajtur me zyrtarin e lartë z. Azemi, si dhe dokumentacionit në dispozicion (*Marrëveshja e Bashkëpunimit datë 16.12.2024, , si dhe vendimi i Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut i datës 16.12.2024*), bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konstaton se zyrtarit të lartë parimisht nuk i ndalohet që të angazhohet si zyrtar i prokurimit në dy apo më shumë autoritete kontraktues, gjë që nuk është e ndaluar as me dispozitat e Ligjit për Prokurimi Publik, ku nenin 23 paragrafi 3 i këtij Ligji ka përcaktuar se:

“Dy apo më shumë autoritete kontraktuese të cilat kanë prokurime të pakta mund të arrijnë marrëveshje që të përcaktojnë personin e njëjti si Zyrtar të Prokurimit”.

Sa i përket pretendimit të raportuesit të rastit, *“a ka hequr dorë z. Azemi nga njëra pagë, sipas nenin 13 paragrafi 2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit”*, bazuar në nenin 2.1 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të datës 16.12.2024, ku thuhet: *“Për shërbimet e ofruara të specifikuara në nenin paraprak të kësaj marrëveshjeje nuk do të kërkohej kompensim”*, rezulton se shërbimet në fushën e prokurimit publik ndaj Komunës së Mitrovicës së Jugut, z. Azemi i ka kryer pa kompensim financiar, përkatësisht pa pagesë. Kjo është konfirmuar edhe gjatë deklaratimit të tij në takim, si dhe është e specifikuar qartë në marrëveshjen në fjalë.

II. Agjencia vendosi si në pikën III. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: “Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë”, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: “Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll BULESHKAJ
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

